

VENDIM
Nr. 792, datë 22.9.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MJEDISIT, PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR
PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR ICSID, NR. ARB/14/26, ALBANIABEG AMBIENT, SHPK, M.
ANGELO NOVELLI DHE COSTRUZIONI, S.R.L., KUNDËR REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi prej 39 050 000 (tridhjetë e nëntë milionë e pesëdhjetë mijë) lekësh, për kryerjen e pagesës së tarifave të avokatëve të kontraktuar për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICSID, nr. ARB/14/26, Albaniabeg Ambient, sh.p.k., M. Angelo Novelli dhe Costruzioni, S.R.L., kundër Republikës së Shqipërisë, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konflikeve në Investimet (ICSID).

2. Fondi prej 39 050 000 (tridhjetë e nëntë milionë e pesëdhjetë mijë) lekësh, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama